



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 10 dhjetor 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Adem Grabovci, Hajdar Beqa, Naim Fetahu dhe Duda Balje.

Munguan: Besnik Bislimi, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në Komision, Arjeta Luli, praktikante dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Ferid Agani (MMPH), Ilir Morina- MMPH, Fazile Hamiti- MMPH, Arben Çitaku- MMPH, Ali Ismaili- MMPH, ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi (MPMS), Drin Haraçia- MPMS, Izedin Bytyçi- MPMS, Kaltrina Mustafa- MPMS, Ibrahim Gylderren- ZAP, Bujar Bajraktari- ZAP, Zukë Zuka- ZAP, Qëndresa Mulaj- ZAP, Florina Merovci- ZPRK, Elvinë Sefiu- Tribuna Chanel dhe Besmir Kokollari- Instituti i CHAT.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, zv. kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.10.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014. I ftuar ministri, z. Ferid Agani;
4. Shqyrtimi i Raporti të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014. I ftuar ministri, z. Arban Abrashi;
5. Të ndryshme.

Zv. kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Zv. kryetari- konstatoi që aprovohet rendi i ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.10.2015

Zv. kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 27.10.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

Zv. kryetari e hapi diskutimin duke ja dhënë fjalën përfaqësuesit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Zukë Zuka tha se raporti i auditimit, tregon çështjet kryesore që dalin nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore për vitin 2014 për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Opinioni është Opinion i Pamodifikuar me Theksim të çështjes. Si Theksim të çështjes, kemi tërhequr vëmendjen për faktin se shpalosja e Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht e besueshme. Përveç kësaj, obligimet e papaguara që ndërlidhen kryesisht me shpronësimet, kanë arritur vlerën mbi 100 milionë euro. Të gjeturat e identifikuar tregojnë se MMPH, ende nuk ka arritur të konsolidojë menaxhimin financiar dhe kontrollet e përgjithshme në cilësi të mjaftueshme. Prandaj kontrollet mbi të hyrat dhe të arkëtueshmet ende nuk po zbatohen në mënyrë efektive. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që MMPH të sigurojë buxhet të mjaftueshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë prokurimi, në mënyrë që projektet të jenë efektive dhe kontrolli efektiv lidhur me menaxhimin e pasurisë. Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2013 të MMPH-së, ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit për vitin 2014, 4 (katër) rekomandime janë adresuar plotësisht, 6 (gjashtë) janë adresuar pjesërisht dhe 3 (tre) nuk janë adresuar ende. Sa i përket buxhetit, buxheti ishte realizuar 94%, edhe pse ka disa çështje të cilat janë gjetur, si për shembull 6 projekte kapitale nuk kanë filluar të implementohen, arsyet janë të ndryshme, si mangësia e projekteve, kontekste pronësore, ngecje në procedurat e prokurimit etj. Sa i përket të hyrave, mekanizmi në inkasimin e të hyrave nuk ishin efikas sa duhet, kjo është reflektuar edhe në rritjen e vlerës së llogarive të arkëtueshme, po ashtu kishte edhe vonesa në deponimin e të hyrave në llogari bankare nga ministri përkatëse. Operatorët ekonomik nuk raportonin për aktivitetet e tyre në ministri, mbi bazën e të cilave caktohen edhe taksat administrative për pagesa, ku inkasimi i tyre ka vonesa në kohë edhe pse ministria kishte ndërmarrë veprimet e tyre, megjithatë kishte edhe kompani të cilat operojnë edhe pa licencë. Për katër projekte kapitale, në të cilat kanë bashkëfinancuar MMPH me komuna, megjithatë procedurat e prokurimit ishin zhvilluar nga vetë komunat, edhe pse është dashur të zhvillohen nga ministria, edhe pse i tërë financimi është bërë nga MMPH. Në çështjen e prokurimit, ka disa lëshime rreth pranimi të punëve, ka pasur pagesa ku raporti i pranimi nuk ka qenë mjaft i qartë,

ka vonesa në përfundimin e punëve, në të cilën ministria ende nuk ka filluar që të zbatojë penalet ndaj operatorëve të cilët kanë pasë vonesa në krijimin e punëve apo të aktivitetëve tjera. Kompensimet në punë jashtë orarit nuk ishin mbështetur në dëshmi për punën e kryer, në aspektin e kategorisë së pagave dhe meditjeve, ndërsa sa i përket obligimeve, mbi 113 milionë euro ishin obligimet vetëm për shpronësime, këto obligime janë, qoftë në mungesë të buxhetit dhe proceseve të tjera të cilat lidhen me shpronësime. Në aspektin e menaxhimit të pasurisë, është vërejtur se ka mungesë në regjistrimin e pasurisë, paraqitjes së vlerës së plotë të pasurive në ministri, kjo ndërlihet më shumë me agjencitë të cilat konkurojnë në kuadër të MMPH. Mandej ka pasur vonesa në inventarizimin e pasurisë, si dhe në menaxhimin e veturave, përkatësish regjistrimit të tyre sipas udhëzimit administrativ. Për adresimin e çështjeve të ngritura, ne kemi dhënë rekomandime, me të cilat ministria është pajtuar dhe ka përgaditur planin e veprimit për implementimin e tyre.

Zv. Kryetari- i jep fjalën ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z.Ferid Agani.

Ferid Agani- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka marrë raportin për funksionimin e ministrisë, për Auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë, më vjen mirë që të gjeturat përfundimtare për vitin 2014 janë më të mira se ato për vitin 2013. Për vitin 2014, shihet një përmirësim evident ku prej 17 rekomandimeve në raport, plotësisht që janë adresuar janë 12, rekomandime pjesërisht të adresuara janë 4, ndërsa vetëm 1 rekomandim është i paadresuar. Prej rekomandimeve po ndalem te këto të fundit, në kategorinë e rekomandimeve pjesërisht të adresuara dhe të paadresuara. Një prej problemeve serioze me të cilat MMPH është ballafaquar në vitin 2014 dhe që ky problem ka vazhduar pastaj edhe në vitin 2015, ka qenë çështja e regjistrimit të pronave të cilat kanë qenë subjekt i procedurave të shpronësimit të ligjit për shpronësim dhe vendimeve përfundimtare të Qeverisë. Në gjatë të tërë vitit jemi marrë me këtë problem dhe ajo që kemi arritur të bëjmë, është se më në fund kemi arritur të elaborojmë udhëzimin administrativ për regjistrimin e pronave të shpronësuara, i cili është para nënshkrimit. Çështja e dytë ka të bëjë me operatorët që nuk raportojnë në ministri, bëhet fjalë në radhë të parë për prodhuesit e ujit të ambalazhuar, të cilët në bazë të ligjit kanë obligim që të raportojnë në ministri për prodhimin e tyre dhe në bazë të këtij raportimi të deklaruar të bëhet nxjerrja e vendimeve përkatëse financiare dhe ngarkesa e tyre, si dhe kryerja e obligimeve ndaj shtetit, ata këtë nuk e kanë bërë dhe për këtë kanë qenë subjekt i padive të ministrisë në gjykatën përkatëse. Ndërsa kur janë në pyetje borxhet, një problem i akumuluar nga viti në vit, rezultat në rend të parë nga planifikimi i dobët të procedurave të shpronësimit, planifikimit të dobët të projekteve strategjike dhe koordinimit të mangët ndërmjet institucioneve dhe ministrive, ka ardhur deri te nxjerrja e vendimeve përfundimtare për shpronësime dhe për objekte strategjike, siç është autoudha dhe projekte tjera dhe njëkohësisht pa përcjellje të mjaftueshme buxhetore nga viti në vit. Ky borxh është rreth 113 milionë euro, por ky është borxh në total edhe i ndërmarrjeve publike të cilat janë të ndërlihdura në proceset e shpronësimeve dhe gjithashtu i poseduesve privat të pronave. Sipas informatave që i kam, janë diku rreth 60 milionë euro të cilat janë borxhe ndaj poseduesve privatë.

Zv. kryetari pyeti a mundeni të na tregoni një analizë më të detajuar për borxhet e bartura, për cilat vite flitet, cilat objekte më konkretisht?

Arben Çitaku tha se ne këtë problem e kemi adresuar në mënyrën më të mirë të mundshme, por është e pamundur që vetëm ministria jonë ta bëjë zgjidhjen. Kryesisht shpronësimet janë bërë në përputhje me vendimet e Qeverisë për interesa nacional dhe kjo e ka përbërë vetëm pjesën e autostradës *Ibrahim Rugova* dhe tani autostradën *Arbër Xhaferi*, të cilat janë cilësuar me interes nacional, si dhe zgjerimin e rrugëve dhe kryesisht kërkesa ka qenë nga Ministria e Infrastrukturës. Ne i kemi marrë gjithë hapat në mënyrë që projektet të mos pengohen në terren, ndërsa të përcillen aktualisht edhe me buxhet. Gjatë fazave të shpronësimit, ne kemi hasur në shumë prona të cilat i kemi kategorizuar në tri grupe, kategoria e parë janë pronarët privatë, kategoria e dytë është në pronat e AKP- së, që janë ende nën posedimin e AKP- së dhe që ne kemi marrë vendimet sepse projekti është dashur të shtrihet në ato prona, si dhe kategoria e tretë nëpër pronat e komunave. Ne ju kemi dhënë përparësi pagesave të cilat kanë të bëjnë vetëm me pronarët privatë, ndërsa këto dy kategoritë tjera pak më vonë për shkak të mundësive buxhetore ta përcjellim nga buxheti i konsoliduar i Kosovës në pagesat e bëra. Çështja e AKP- së, mendoj që do të duhet të zgjidhet në nivel të Qeverisë, për shkak që edhe AKP- ja është pjesë përbërëse e institucioneve tona. Ndërsa me komunat e kemi bërë një programim të borxhit, varësisht prej nevojave të cilat ata i kanë, prandaj adresimi dhe analiza e kësaj është bërë në këto kategori dhe për këtë e kemi njoftuar Ministrinë e Financave.

Ferid Agani tha se rekomandimi i katërt që ka qenë pjesërisht i adresuar, ka të bëjë me inventarizimin dhe me menaxhimin e pasurisë në përgjithësi, mendoj që është arritur një përparim, kryesisht kemi pas të bëjmë më inventarizimin e pasurisë së Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe ka një avancim në këtë proces, është punuar në këtë drejtim gjatë këtij viti edhe më shumë, në vitin 2014 ka qenë një arritje e pjesshme, por shpresoj që këtë vit të dalim me vlerësim pozitiv sa i përket këtij rekomandimi dhe ta plotësojmë në tërësi. Rekomandimi që ka mbetur i pa adresuar, që ka pas të bëjë me projekte të përbashkëta ndërmjet ministrisë dhe komunave, ku disa projekte në tërësi janë realizuar nga komuna edhe pse kanë qenë mjete financiare të alokuara në ministri, ky ka ngelur i pa adresuar për shkak të përgjegjës e cila ka ardhur nga Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik, të cilit ju ka adresuar ministria për t'u kuptuar a është kjo e lejueshme në mënyrë që të kemi një menaxhim sa ma efektiv të mjeteve financiare në dispozicion. Arsyeja ka qenë pse kjo u bë në komuna, në radhë të parë për shkak se ekziston një situatë specifike në sektorin e mjedisit, ku ministria është përgjegjëse për resurset natyrore si resurset ujore, shumë projekte kanë të bëjnë me kanalizim, me ujësjellës, por menaxhimi i këtyre resurseve në instancën e fundit bëhet nga kompanitë publike të cilat janë regjionale dhe komunale.

Zv. Kryetari- Desha të ngriti një çështje edhe pse nuk është në material, e di se në raportet e kaluara ka qenë objekt diskutimi dhe shqetësimi. Fjala është për mbetjet shëndetësore të njerëzve në Qendrën Klinike Universitare, varrosja apo djegia e tyre, pjesë e së cilës ka qenë edhe MMPH, nëse mundeni të na thoni diçka më shumë se cilat janë projeksionet e juaja në tejkalimin e këtij problemi?

Ferid Agani tha se ky është problem mjaft i madh ndër sektorial, ndarjet në mes të MMPH dhe Ministrisë së Shëndetësisë, kjo çështje është e rregulluar me akt nënligjor të nxjerrë nga

Ministria e Mjedisit, pra me udhëzim administrativ i cili me detaje parasheh të gjitha procedurat. Në esencë shkatërrimi i këtyre mbetjeve në mënyrë optimale dhe në pajtim me ligjin duke i respektuar Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, mund të bëhet vetëm në furrat e larta të cilat janë të licencuara për këtë qëllim dhe për këtë kemi të licencuar furrën e çimentos në Han të Elezit dhe në kompaninë Feronikel në Drenas, temperatura në këto furra arrihet mbi 1.200 gradë celsius, kështu që kemi një shkatërrim të plotë.

Adem Grabovci- Ne na gëzojnë rezultatet, gjegjësisht ndryshimet pozitive që po ndodhin jo vetëm në një institucion, por në përgjithësi në të gjitha institucionet, në rritjen e shkallës së përgjegjësisë dhe të disiplinës. Ne e dëgjuam ministrin dhe arsyetimet për mua ishin shumë të arsyeshme. Mendoj që kishte me qenë mirë nga auditori t'i ketë parasysh në të ardhmen që disa adresime në të gjetura, se përgjegjësia është në rastin konkret e ministrisë, është te mos angazhimi apo neglizhenca tjera apo është mungesa e infrastrukturës ligjore, sepse po shihet qartë se këtu nuk është faji i ministrisë, por te shpronësimet kemi për shembull, mungesa e infrastrukturës ligjore është një problem që ministrisë ia ka pamundësuar që të tregohet e suksesshme. Prandaj vlerësoj që kjo duhet të merret parasysh. Pastaj kemi gjithashtu edhe te operatorët, të cilët i sqaroj ministri shumë mirë, që nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me neglizhencën apo punën në ministri, por janë faktorë të tjerë që kanë ndikuar që ministria të mos e kryej punën e saj me sukses, gjithashtu kjo ndodh kur kemi të bëjmë edhe me borxhet, si dhe me regjistrimin e pasurisë dhe shumë çështje të tjera. Kërkoj prej auditorit që edhe këtë pjesë ta ketë parasysh dhe mundësisht t'i identifikojë edhe shkaktarët që kanë ndikuar në mosrealizimin dhe mos përmbushjen e disa të gjeturave.

Synavere Rysha- Duke e shfletuar raportin e shih se gjatë kohës sa është punuar, gjatë vitit 2014, ka pasur disa parregullsi, ka pasur ndoshta lëshime gjatë procedurave, por nga raportimi i ministrit duket se mjaft mirë është avancuar në vitin 2015, kanë arritur me i adresuar mjaft mirë rekomandimet e auditorit, është punuar dhe më gëzon ky fakt. Duke e ditur që raporti ka opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes dhe çështja është kryesisht te evidentimi i pasurisë, kisha dashur të sqarohet një detaj që ka të bëjë me këtë çështje, te evidentimi i pasurisë, konkretisht i disa veturave zyrtare të cilat në vitin 2014 kanë qenë si pasuri e ministrisë. Mirëpo kanë bartë të ardhura të komunës, si është çështja tani, a i keni kthyer në kuadër të ministrisë dhe gjithashtu te shpronësimet, ishte një sqarim i arsyeshëm për mua, sepse borxhi diku 160 milionë është një borxh mjaft i lartë, këto janë çështjet që më kanë interesuar më shumë.

Arben Çitaku tha se te çështja e bartjes së pronës, te regjistrimi i pronës i kisha ndarë në dy sfera, regjistrimi i pronës në aspektin e makinave që nuk janë regjistruar, kjo ka ndodhur si pasojë e bartjes së kompetencave të Parkut Nacional, Bjeshkët e Nemura në Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit, meqenëse e kemi pritur fundin e regjistrimit të atyre veturave dhe pastaj fillimin e procedurave dhe kjo ka ndodhur tashmë, por në momentin që është kryer auditimi ka qenë procesi i mbetur në gjysmë, pra nuk ka përfunduar afati i regjistrimit të atyre automjeteve, sepse janë procedurat e bartjes së pronës, ato kanë qenë në regjistrim, por si të tilla kanë qenë me targa 03, tashmë është adresuar kjo çështje dhe është zgjidhur. Ndërsa problemi i regjistrimit në total të pasurisë, kjo ka të bëjë më shumë me regjistrimin e pronave, e kemi themeluar regjistrin e pronave, mirëpo bartja në kadastrë është dashur që të plotësohet me një udhëzim të veçantë administrativ, i cili neve na mundëson konform ligjit të kadastrit, për me e bartë këtë pronë me vendime të Qeverisë, në emër të Qeverisë prej pronarëve privatë, ky është një proces kompleks,

kur e kemi parasysh që pronat janë jashtëzakonisht sensitive, atëherë ne e kemi pasur një procedurë, ku thuhet se pjesërisht është e adresuar për faktin se duhet miratuar fillimisht udhëzimi administrativ dhe pastaj të mundësohet bartja e këtyre pronave. Tani udhëzimi është para miratimit, besoj që deri në fund të vitit ministri do ta nënshkruajë dhe do të fillojë menjëherë bartja e pronave në emër të Qeverisë. Sa i përket borxheve, për privat ne i kemi gjithsej 59 milionë euro, të cilat i kemi dhënë përparësi për pagesa, duke e marrë parasysh që ne na përcjellë Qeveria vetëm 27 milionë buxhet, praktikisht prapë nuk është e adresuar, por jo për fajin e ministrisë, ndërsa pronat publike që nënkuptojnë komunat i kemi 15.5 milionë euro, prona shoqërore që nënkupton AKP- në janë 45.5 milionë euro dhe vetëm objekti i Rilindjes është 16.6 milion euro.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, vendosi që Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2014, të mos adresohet për Seancë Plenare, por rekomandimet t'i adresohen vetëm Ministrisë.

4. Shqyrtimi i Raporti të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014

Zv. kryetari ia dha fjalën përfaqësuesit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Bujar Bajraktari tha se ky raport ka të bëjë me Pasqyrat Financiare për MPMS për vitin 2014, sa i përket opinionit, ky është Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes. Si Theksim të Çështjes, Auditori i Përgjithshëm ka tërhequr vëmendjen për faktin se subvencionet në vlerë prej 872,995€ janë dhënë nga ministria pa bazë të qartë ligjore, kjo për faktin se ministria kishte nxjerrë një udhëzim të brendshëm mbi dhënien e një kategorie të subvencioneve, ku përcaktoheshin edhe përfituesit- disa OJQ. Përveç kësaj, projektet në vlerë prej 202,460€ janë financuar/përkrahur pa raporte përcjellëse, si dhe pagesat nga subvencionet dhe transferet në vlerë prej 216,872€ ishin bërë për mallra dhe shërbime. Sa i përket rekomandimeve të vitit paraprak, niveli jo i kënaqshëm i implementimit të rekomandimeve të mëhershme, duke qenë se vetëm 9 nga 23 rekomandimet ishin implementuar plotësisht, 3 ishin në proces të implementimit, derisa 11 të tjera nuk ishin implementuar. Sa i përket Qeverisjes dhe Raportimit, sipas dispozitave ligjore për delegimin e përgjegjësisë për skemën sociale, komunat duhet të paraqesin raport vjetor me shkrim për shërbimet e ndihmave sociale të çdo viti. Kjo nuk ishte bërë, duke shkaktuar kështu edhe mos harmonizimin e planeve vjetore lidhur me shërbimet e ndihmës sociale. Sa i përket planifikimit të kërkesave buxhetore, kërkohet përmirësim dhe bashkëpunim më i mirë me Ministrinë e Financave, kjo për shkak se buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar ka qenë diku rreth 55 milionë më i lartë. Sa i përket ekzekutimit të buxhetit, në total ishte i kënaqshëm duke arritur në rreth 99%. Megjithatë buxheti për investime kapitale ishte shpenzuar vetëm 59%. Në këtë kishte ndikuar një numër i projekteve që nuk janë realizuar si pasojë e vonësive në procedurat e prokurimit. Ndërsa, prokurimi ishte përcjellë nga disa mangësi të vogla procedurale dhe administrative, të cilat megjithëse nuk ishin shumë materiale në krahasim me

madhësinë e buxhetit të ministrisë, duhet të evitohen në të ardhmen. Te Shpenzimet për të cilat nuk ka nevojë për prokurim, janë vërejtur një varg mangësish duke filluar nga mungesa e tarifave për kompensimin e mjekëve të angazhuar në komisione, pastaj menaxhim/arsyetim jo i duhur i avanseve për udhëtime jashtë vendit etj. Te Shpenzimet e Pagave dhe Menaxhimi i Personelit, kemi vërejtur se pesë zyrtarë ishin avancuar me vendim nga sekretari i Përgjithshëm, pa zhvilluar fare procedurat e konkurrencës të brendshme. Madje, për njërin nga ta nuk ishte bërë vlerësimi i performancës fare për vitin 2013. Këto avancime janë në kundërshtim me kriteret për avancimin në karrierë, përveç kësaj tri pozita udhëheqëse ishin mbuluar nga ushtrues detyre për kohë më të gjatë se sa është e lejuar dhe nuk ishin filluar procedura për rekrutimin/plotësimin e këtyre pozitave. Fusha e Subvencioneve dhe Transfereve është fusha kryesore e shpenzimeve, duke qenë se rreth 97% e buxhetit të MPMS-së i takon kësaj kategorie. Të gjeturat në këtë fushë janë të detajuara në raport, ndërsa ato më të rëndësishmet janë si vijon: Te pensionet bazike kishte pagesa pas vdekjes së pensionistëve (të verifikuara nga mostrat e testuara 7.569 euro). Te DFDIL-ja, nuk kishte dëshmi që sigurojnë që përfituesit e trajtimeve e kanë vërtet këtë status, derisa ne kemi gjetur se disa nga ta nuk i takojnë kësaj kategorie. Te pensionet për personat me aftësi të kufizuar kishte vonesa në procesin e verifikimit, si rrjedhojë kishte pagesa retroaktive dhe pagesa me gabime. Te asistencë sociale kishte mangësi dhe vonesa në procesin e përzgjedhjes së familjeve përfituese, mangësi në dokumentacionin e përfituesve, mospërputhje në mes vendimeve dhe pagesave etj., si dhe gjithashtu te pensionet e parakohshme të Trepçës kanë përfituar 69 persona të cilët nuk i kishin plotësuar kriteret (moshën), ato pensione për 2014 kapin shumën 79.485 euro.

Sa i përket Menaxhimit të Pasurisë, ministria nuk kishte transferuar në pronësi të komunës së Podujevës shtëpitë në vlerë prej 384. 901€, ashtu siç parashihej me marrëveshje dhe kishte mangësi në menaxhimin e veturave zyrtare, për disa vetura nuk kishte evidenca rreth shfrytëzimit të tyre. Ndërsa, Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk kishte arritur ta realizojë planin e punës dhe po ashtu nuk ishin mbajtur në dosje të auditimit dëshmitë rreth të gjeturave të shpalosura nga auditimi i brendshëm.

Zv. kryetari- i jep fjalën ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi.

Arban Abrashi tha se fillimisht me marrjen e detyrës si ministër, një prej preokupimeve dhe shqetësimeve ka qenë edhe vendosja e një sistemi më të mirë të financave, bazuar në ligjin përkatës, gjithashtu të shpenzimit të parave publike. Ne i kemi ndërmarr disa veprime, pas pranimit të raportit të ZAP- it, lidhur me PVF të vitit 2014, kam autorizuar sekretarin e Përgjithshëm për të hartuar planin e veprimit për t'i implementuar rekomandimet e dhëna në raportin e Auditorit të Përgjithshëm. Deri më tani kemi arritur të implementojmë shumicën e rekomandimeve, si vijon: Është hartuar plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve duke përcaktuar afatet kohore dhe njësitë që janë përgjegjëse për implementim, është adresuar rekomandimi lidhur me raportimin e brendshëm menaxherial, pasi që të gjitha raportet javore të departamenteve dërgohen te sekretari, pastaj diskutohen në mbledhjet javore të stafit. Te Realizimi i Buxhetit, në të gjitha kategoritë, duke përjashtuar kategorinë e investimeve kapitale, realizimi i ekzekutimit të buxhetit ka qenë në nivel të kënaqshëm, kurse te investimet kapitale ka pasur ngecje në realizimin e projekteve, sidomos te përqindja e ulët që ka ndikuar projektet të cilat janë paraparë në komunat me shumicë serbe, pasi që edhe marrëveshjet e mirëkuptimit me komunat janë nënshkruar në qershor dhe procedurat e tenderimit atje kanë marrë kohë. Te fusha

e Prokurimit, është arritur të implementohen rekomandimet e auditorit, që kanë të bëjnë me zotimin e mjeteve para se të nënshkruhen kontratat, pranimi i punëve, projekteve apo shërbimeve që bëhet nga zyrtarët kompetent, menaxher të kontratave, ndarja e detyrave gjatë aktiviteteve të prokurimit bëhet konform rregullave. Te rekomandimet që kanë të bëjnë me Pagesën e Komisioneve Mjekësore, aktualisht është në diskutim publik udhëzimi administrativ, ku përcaktohet mënyra e angazhimit, si dhe forma e kompensimit të mjekëve të angazhuar në komisionet mjekësore brenda ministrisë dhe pas marrjes së komenteve ky udhëzim administrativ do të hyjë në fuqi. Te Menaxhimi i Avanseve për Udhëtime Zyrtare, nuk i kemi arritur t'i mbyllim avanset e hapura që kanë mbetur nga vitet e kaluara. Sa i përket këtij viti kemi pasur disa vonesa në mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare, por jemi duke bërë përpjekje që të përmirësojmë menaxhimin e avanseve. Te rekomandimet që kanë të bëjnë me Procedurat e Gradimit dhe Avancimit të Nëpunësve Civilë dhe shumë gradime tjera të stafit, bëhen përmes procedurave të konkurseve të brendshme. Sa i përket përkrahjes financiare ndaj përfituesve publikë dhe OJQ-ve, në gjysmën e dytë të vitit, kemi nxjerrë rregulloren për kriteret e përfitimit të granteve dhe subvencioneve dhe të gjithë përfituesit tani janë të obliguar me marrëveshje të mirëkuptimit, që të sjellin dëshmitë mbi shpenzimet e tyre. Sa i përket kontraktimit të shërbimeve me OJQ- të apo me strehimoret, këtu ministria nuk ka pasur mundësi që të adresojë këtë rekomandim në tërësi, pasi që mjetet buxhetore kanë qenë të destinuara në kategorinë e subvencioneve. Sa i përket skemave pensionale, deri tani kemi arritur marrëveshje me Agjencinë e Regjistrimit Civil, jemi në përfundim edhe për marrëveshjen edhe me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe bashkësitë të tjera fetare, vetëm pas kësaj periudhe pasi që ka hyrë marrëveshja në fuqi, kemi filluar t'i kontrollojmë, kemi bërë kthime të mjeteve fillimisht prej 255 mijë euro përmes krahasimit të listave. Sa i përket rekomandimeve që kanë të bëjnë me çështjen që lidhen me Pensionet e Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës, përmes departamentit përkatës që merret me këto, ne kemi punuar në mënyrë që secili përfitues i kësaj kategorie të ofrojë dokumentacion valid, në mënyrë që të dëshmojë që e meriton të jetë përfitues i këtyre skemave. Pensionet e personave me aftësi të kufizuar, përmes krahasimit të raporteve të përfituesve me skemat e tjera, është punuar në pastrimin e listave në mënyrë që të shmangen pagesat nga dy kategori të ndryshme, gjithashtu edhe komisionet mjekësore kanë qenë shumë aktive, në mënyrë që procesi për aplikim deri te aprovimi të jetë më i shpejtë dhe më i disiplinuar. Te Skema e Asistencës Sociale, mund të themi se kemi forcuar mekanizmat e kontrollit, gjithashtu edhe inspektimet, kjo ka ndikuar në uljen e numrit të përfituesve në këto skema, edhe është raportuar edhe më herët që në bazë të pastrimit të listave, qoftë me ATK- në, qoftë me institucione të tjera, jemi duke punuar në ndërlidhjet, vetëm këtë vit kemi kursyer ndoshta deri në 3 milionë euro. Te çështja e Pensioneve të Parakohshme të Trepçës, kemi mbajtur kontakte të shpeshta me menaxhmentin, me qëllim të eliminimit të lëshimeve. Ajo çka është shqetësim edhe për media, është se një numër i tyre kanë mbetur jashtë skemës, por kjo ka të bëjë me implementim të ligjit, ku është së paku moshë 50 vjeçare dhe është e pamundur për ne, si ministri, të ndërhyjmë. Te rekomandimi për mostransferimin e pasurisë në pronësi të komunës, kjo ka të bëjë me shtëpitë e ndërtuara në Podujevë, ky rekomandim është adresuar dhe kjo pronë ka kaluar në pronësi të komunës së Podujevës. Te Menaxhimi i Automjeteve Zyrtare, është arritur që të zbatohet rekomandimi i auditorit, për autorizim dhe përdorim të veturave zyrtare për 24 orë kanë vetëm ministri, zëvendësministri dhe kryeinspektori i punës, sa i përket përdorimit të veturave private për nevojat zyrtare, kjo ndodh vetëm në dy raste, që kanë të bëjnë me inspektoriatin e punës dhe pritjet që edhe këto vetura të zëvendësohen me vetura zyrtare. Sa i përket rekomandimeve të auditimit të brendshëm, këto janë zbatuar plotësisht.

Hajdar Beqa- Ne si komision, e kemi shqyrtuar Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2014, edhe pse bëhet fjalë për një periudhë në të cilën ministri nuk ka udhëhequr. Realisht është një ministri që ka pasur më së shumti të gjetura dhe më gëzoj fakti se ministri e bëri një sqarim të të gjeturave të auditorit në mënyrën më profesionale të mundshme, janë shumë shqetësime që realisht kanë qenë edhe të pakuptimta, si për shembull, po ndalem në tri shqetësime, si menaxhimi jo i duhur i avanseve të udhëtimit zyrtarë, mua më shumë më shqetësoj fakti se në këto udhëtime zyrtare kemi raste ku udhëtojnë edhe persona që nuk janë punëtorë të ministrisë, kemi raste ku nuk ka mbyllje të avanseve apo ministri paraprak ka marrë vendime edhe pa dëshmi të zyrtarëve të cilët kanë udhëtuar, gjithashtu ne e kuptojmë mungesën e veturave zyrtare dhe kjo nuk është e pëlqyeshme, por ministri duhet të shikojë që në të ardhmen mos të ketë mundësi që veturat private të përdoren për çështje zyrtare, sepse ka mundësi të keqpërdorimit të parasë publike, gjithashtu te gradimi i stafit pa procedura, mendoj që duhet të bëhen përmirësime për shkak që është shkelje e drejtëpërdrejtë e ligjit mbi shërbyesit civilë.

Adem Grabovci- Ministër ju përgëzoj për sukseset që keni treguar në këtë kohë, të cilat po shihen në bazë të raportit. Uroj që raporti i ardhshëm i auditorit të jetë i kompletuar edhe me këto që i prezantuat dhe që do t'i kryeni me sukses dhe këto të gjetura do t'i evitoni. Unë e kam vetëm një pyetje rreth këtij 55 milionshit, kisha kërkuar një sqarim më shumë. Ne e dimë që në shumë raste nuk është shkaktare ministria, por janë disa faktorë tjerë që kanë ndikuar në mospërbushjen e disa obligimeve.

Synavere Rysha- Më gëzon fakti që ministri i ka adresuar mjaft mirë së bashku me stafin të gjitha të gjeturat që auditori i ka konstatuar gjatë auditimit në MPMS, pashë një elaborim mjaft të mirë nga ministri dhe uroj që kjo të jetë punë permanente e juaja në ministri dhe raporti i vitit 2015 të jetë shumë më i mirë dhe besoj që do të jetë më i mirë dhe më i avancuar. Raportuat mjaft mirë, por ndoshta pak si zbehtë mbeti çështja te përkrahja financiare ndaj përfituesve publikë dhe OJQ- ve pa bazë ligjore. Kjo është një çështje që na ka ngacmuar të gjithëve dhe është parë që është bërë një lëshim, ministri ka nxjerrë një udhëzim administrativ, por nuk e ka bazuar në ligje, këtu nëse numdeni të na jepni sqarime më shumë.

Naim Fetahu- Ne jemi duke folur për raportin e vitit 2014 dhe ministri nuk ka qenë në atë kohë ministër. Po ministri na tregoj se si do t'i adresojë çështjet e gjetura, dëshiroj ta përgëzoj ministrin për kursimet që ka krijuar sa i përket pastrimit të listave. Mendoj që në këtë drejtim ministri ka punë edhe pak ma shumë, sepse ka mundësi që të pasurohen edhe më shumë listat te personat që marrin paga të dyfishta prej institucioneve të Republikës së Kosovës. Mendoj që duhet shikuar bazën ligjore dhe në këtë drejtim mund të vazhdohet. Sa i përket mosmbylljes së avanseve, mendoj që është mirë të na sqaroni se për çfarë vlere bëhet fjalë, gjithashtu edhe një kontrollë më e madhe te prokurimi është e domosdoshme në këtë ministri.

Arban Abrashi tha se shqetësimi im ka qenë te subvencionet dhe që muajt e parë kam pasur presion prej ish përfituesve për shërbime të ministrisë, qoftë sociale, qoftë të tjera, që me vazhduar kontrata dhe unë nuk e kam marrë atë hap për shkak kufizimeve ligjore dhe kam formuar një komision duke u bazuar në proceduar të rregullta, i cili ka punuar 5-6 muaj, sepse është dashur të konsultohet edhe Ministria e Financave dhe kemi hartuar rregulloren për ndarjen

e subvencioneve dhe në bazë të kësaj janë kriteret, janë shumat dhe janë procedura mjaft të specifikuar se si bëhet ndarja e shpenzimeve publike për OJQ- të, mendoj që kjo ka vendosur një rregull si brenda ministrisë, por gjithashtu edhe te të gjithë ata ofrues të shërbimeve sociale dhe kjo bëhet duke e respektuar këtë rregullore. Shqetësimi tjetër ka pasur të bëjë me asistencën sociale, prapë në koordinim me faktorët e tjerë relevant, edhe me kryetarët e komunave, që ka një rrjedhje të parasë te njerëzit të cilët nuk e meritojnë këtë skemë, sepse nuk i plotësojnë kriteret. Një prej kërkesave ka qenë implementimi i marrëveshjes me Administratën Tatimore të Kosovës, gjithashtu muajt e parë jemi ballafaquar me presion publik se po largohen kaq familje, por në koordinim me kryetarët e komunave ka qenë çështje që ne e kemi përcjellë listën nga ATK- ja që këta persona kanë të hyra. E fundit që është në funksion të kursimit ka qenë marrëveshja me Agjencinë e Regjistrimit Civil, ajo shifër që e përmendëm 255 mijë, është vetëm fillimi çka mundemi me kursye, kjo ka ndodhur në tetor, por jam i bindur që kemi gjetur disa njerëz që kanë qenë të vdekur dhe familjet e tyre kanë vazhduar të marrin pension. Avanset mbesin problem, unë kam kërkuar nga gjithë zyrtarët, 900 shërbyes civilë në ministri, kush ka avanse të hapura, mos me lejuar më të udhëtojnë pa i mbyllur këto.

Izedin Bytyqi tha se sa i përket avancave të hapura, është një shumë prej 30.000 euro, e cila ka mbetur prej vitit të kaluar. Këtë vit i kemi pasur 2-3 raste të stafit brenda ministrisë, të cilët kanë hezituuar që t'i kthejnë mjetet, por më në fund janë detyruar, por kemi pasur vonesë të mbyllja e avancave. Sa i përket veturave zyrtare, përveç ministrit, zëvendësministrit të punës dhe kryeinspektorit, të tjerët nuk kanë të drejtë të përdorin këto vetura 24 orë, ndërsa të çështja e gradimeve, kemi pasur një rast ku ka qenë një vend i lirë i punës dhe ka pasur të plotësohet brenda ministrisë dhe e kemi kryer me konkurs të brendshëm, gjithashtu edhe pozitat me ushtrues detyre, për të gjitha janë shpallur konkurset e brendshme. Te çështja e mungesës së mjeteve prej 55 milionë euro vitin e kaluar, kjo është mbuluar me vendim të Qeverisë. Kjo ka ndodhur si pasojë që Ministria e Financave nuk i ka përfillur kërkesat e ministrisë për buxhetin, kanë hedhur më pak sesa kanë kërkuar, për këtë vit ky minus është 4.500.000 euro. Ndërsa te çështja e prokurimit, ka pasur progres dhe gjendja është shumë e mirë, janë zbatuar rekomandimet.

Arban Abrashi tha se te avancat e jashtme, është situatë specifike, sepse ne, si ministri, përpos të gjithë këtyre sektorëve që kemi, bazuar në ligjin kemi edhe Këshillin Ekonomik Social, i cili udhëhiqet në mënyrë rrotative, këtë vit kam qenë unë, vitin tjetër do jenë përfaqësuesit e bizneseve, vitin tjetër vijnë përfaqësuesit e sindikatave dhe janë 2- 3 takime të nivelit botëror, Konferenca Botërore ku ne duhet të shkojmë dhe ftesat janë për tri partitë, si për punëdhënësin, si për organizatat, si për institucionet dhe në këtë rast kemi shkuar të gjithë në Organizatën Ndërkombëtare të Punës në Gjenevë, ku kanë marrë pjesë 170 shtete dhe tani është dashur të gjejmë mënyra ligjore që të paguhen përfaqësuesit e sindikatave dhe përfaqësuesit e bizneseve në këtë konferencë. Kjo ka qenë arsyeja pse ka pasur avanse për persona jashtë ministrisë, por këto janë të paguara nga Buxheti i Këshillit Ekonomik Social, buxhet i cili është brenda ministrisë sonë.

Naim Fetahu tha se kam qenë një kohë anëtar i këtij komisioni, vërtet gjatë tërë kohës ky komision ka pasur probleme financiare. Mendoj që kërkesat që ka ky komision janë jashtëzakonisht të vogla, të arsyeshme dhe mendoj që duhet me i mbështetur, për me i ruajtur

edhe raportet dhe bashkëpunimin me aktoret e tjerë që janë të rëndësishëm për ne, për Qeverinë dhe për gjithë shoqërinë.

Zv. kryetari tha se ndjej kënaqësi që sfidat dhe problemet i keni analizuar dhe presim që në plan veprimin konkret ju do t'i adresoni, ju presim në raportin tjetër me rezultate konkrete.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, vendosi që Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2014, të mos adresohet për Seancë Plenare, por rekomandimet t'i adresohen vetëm Ministrisë.

5. Të ndryshme

Zv. kryetari- Në javën e ardhshme, të mërkurën më datë 16 dhjetor, e kemi planifikuar me auditorin, me GIZ- in, të kemi një dëgjim publik për raportet e audituara të komunave. GIZ- i na ka ofruar ndihmë për shpenzimet që do ketë, ky dëgjim publik do mbahet në Garden. Ne do bisedojmë për rekomandimet apo të gjeturat që janë sfida të përbashkëta të komunave, ku prej disa prej tyre janë adresuar dhe jepen disa rekomandime, por gjithashtu do të bisedohet edhe për komunat në mënyrë specifike. Njëra prej rekomandimeve bazike që unë mendoj që duhet të jetë, në kuptimin që ne duhet t'i obligojmë kuvendet komunale që raportet me rekomandime të auditorit të shqyrtohen në asamblatë komunale dhe për të njëjtat rezultate të njoftohet ZAP- i për shqyrtimin e atyre raporteve dhe pastaj të hartojë një raport të përgjithësuar për mënyrën dhe nivelin e implementimit të atyre rekomandimeve, pra t'i përcjellim ata dhe në këtë mënyrë të mbulohet edhe pushteti lokal në mënyrën më të mirë të mundshme. Komisioni do të ketë një takim përgatitor paraprakisht ditën e martë, më 15 dhjetor. Në këtë takim do jenë prezent anëtarët e KMFP, Asociacioni i Komunave, kryetarët e Komunave dhe drejtorët e Buxhetit, do ishte mirë të shtohen gjithashtu edhe drejtorët e Auditimit. Me këtë e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv. kryetari i Komisionit,

Ali Sadriu